



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/18

Datë: 11.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 10,887,186.45€ (dhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e pesë cent), për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, shuma prej 10,874,186.45€ (dhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e pesë cent), nga nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me kod 320, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si në vijim:
 - 2.1. Në nënprogramin "Sekretariati" me kod 14100, shuma prej 221,000.00€ (dyqind e njëzet e një mijë euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa";
 - 2.2. Në nënprogramin "Zgjedhjet" me kod 14200, në kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:
 - 2.2.1. Shuma prej 10,621,186.45€ (dhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e pesë cent), në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime";
 - 2.2.2. Shuma prej 32,000.00€ (tridhjetë e dy mijë euro), në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime Komunale".
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, shuma prej 13,000.00€ (trembëdhjetë mijë euro), nga nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale" nga projekti "Shpenzimet e Paparashikueshme" me kod 13255, dhe ndahen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me kod 320, në nënprogramin "Zgjedhjet" me kod 14200, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin e ri "Blerja e pirunetës me derivate për QNR/Depo".
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë